



Adresa: Rruga "Paisi Vodica", 1025, Tiranë



Adresa: Qender, Fushë-Arrëz

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Bashkia Fushë-Arrëz

Nr. 2534 Prot. Datë 10 / 09 /2024

Nr. _____ Prot. Datë _____ / _____ /2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot më datë; 10 / 09 /2024, ndërmjet **Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT)** përfaqësuar nga **Rektori, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku**, dhe **Bashkia Fushë-Arrëz**, përfaqësuar nga **Kryetari Hil Curri**. Nisur nga qëllimi për të forcuar dhe thelluar marrëdhëniet ndërmjet dy insitucioneve, bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kjo marrëveshje mbështetet në nenin 3 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe neni 2 pika 6 e Statutit të UBT ; Ligjin Nr 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", kreu III, Neni 8 dhe 9 ; Ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet", neni nr.11 VKM Nr.188, datë 13.3.2019, "Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre" ; VKM-në nr.134 date 3.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016 të këshillit të ministrave "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive" ; VKM-në nr.361, datë 12.05.2010 "Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullosor publik" si dhe Shkreses nr.1639 Prot date 17.05.2024 "Kërkesë për mbështetje teknike për hartimin e Planeve të Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Fushë-Arrëz" të Bashkisë Fushë-Arrëz.

Neni 2

Qëllimi i kësaj marrëveshje është institucionalizimi i bashkëpunimit ndërmjet **Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT)** dhe **Bashkisë Fushë-Arrëz** në fushën e pylltarisë, si dhe ruajtjen, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të mjedisit, tokës bujqësore, pyjeve dhe rrjedhieve ujoreve. Secili institucion do të caktojë një person përgjegjës për bashkëpunimin, i cili do të referojë tek autoritetet drejtuese kompetente aktivitetet e bashkëpunimit.

Neni 3

Bashkia Fushë-Arrëz angazhohet në përfshirjen e ekspertëve të Universitetit Bujqësor në përputhje me nevojat e saj në të gjitha fushën e menaxhimit të burimeve pyjore dhe atyre natyrore.

Neni 4

Me qëllim që të arrihen objektivat e sipërpërmendura, të dyja institucionet angazhohen të sigurojnë mjetet e nevojshme, sipas normave në fuqi. Shpenzimet, e identifikuara me mirëkuptim, do të mbulohen nga buxheti i institucioneve të përfshira në këtë marrëveshje ose edhe nga burime të tjera.

Neni 5

Bashkia Fushë-Arrëz angazhohet që do të kontraktojë **Universitetin Bujqësor të Tiranës** (Fakultetin e Shkencave Pyjore dhe Fakultetet e tjera) në kryerjen e shërbimeve të mëposhtme:

- Kryerjen e studimit të plotë për hartimin e Planit të Mbarështrimit të Ekonomisë Pyjore “Iballe-Mzi” në pronësi të kësaj bashkie dhe me pas ofrimin e mbështetjes për kryerjen e planeve të mbarështrimit edhe në ekonominë e tjera pyjore.
- Hartimin e planeve të rehabilitimit të sipërfaqeve të djegura, boshe, me bimësi pyjore dhe djerrë.
- Kryerjen e studimeve për luftimin e semundjeve dhe dëmtuesve në pyje

Neni 6

UBT ka detyrimin që të angazhojë specialistët më të mirë të fushës dhe të sigurojë produkte apo shërbime sipas nevojave që ka Bashkia **Fushë-Arrëz**. Po kështu, **UBT** angazhohet të organizojë trajnime, seminare dhe workshope të përbashkëta që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë, agroturizmit, pylltarisë etj.

Neni 7

Palët do të bashkërendojnë perpjekiet e tyre për hartimin e projekteve dhe studimeve në fushat e lartpërmendura me qëllim sigurimin e mbështetjes financiare nëpërmjet aplikimit të projekteve tek donatorë të ndryshëm.

Neni 8

UBT dhe Bashkia **Fushë-Arrëz** sigurojnë dhe shpërndajnë informacion me synim rritjen e vlerës bashkepunimin e ngushtë në arritjen e objektivave të vendosura në këtë marrëveshje.

Neni 9

Fakultetet e **UBT** dhe stafi i Bashkisë **Fushë-Arrëz** angazhohen të koordinojnë aktivitetet që lidhen me zhvillimin e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit në territorin e njesive vendore.

Neni 10

Bazuar në këtë marrëveshje, **UBT** dhe Bashkia **Fushë-Arrëz** nënshkruajnë këtë marrëveshje dypalëshe me qëllim realizimin e detyrave konkrete.

Neni 11

Kjo marrëveshje do të ketë një kohëzgjatje prej **4 (katër) vjetësh** nga data e nënshkrimit nga ana e drejtuesve të dy Institucioneve. Marrëveshja hartohet në 2 kopje, dhe mund të rinovohet vetëm me dakortësinë e të dyja palëve. Ndryshimet, përmirësimet ose anulimi i kësaj marrëveshje behet me pëlqimin e të dy palëve duke njoftuar paraprakisht me shkrim jo më pak se 2 muaj përpara.

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Rektori

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU



Bashkia Fushë-Arrëz

Kryetari

HiL CURRI

